



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Datë 11.02.2026

Drejtuar: “OPTIMA COMMUNICATION” NIPT K71903025A,

**Me adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera
28B, Tiranë.**

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall;

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”;

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-62627-09-25-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Realizimi dhe prodhimi i materialeve promociionale për promovimin e markës, shërbimeve postare - financiare dhe produkte filatelike” me fond limit 5.000.000 (pesë milion) lekë pa TVSH.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **26.09.2025.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini,

nr.55, 29.09.2025.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐ ☒

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ALBDESIGN PSP” SH.P.K., me NIPT L51819005Q, me vlerë të ofertës ekonomike 4.600.700 (katër milion e gjashtëqind mijë e shtatëqind) lekë pa T.V.SH.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori Ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SH.P.K., me NIPT K71903025A, me vlerë të ofertës ekonomike 3.750.000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori Ekonomik “INPRESS” SH.P.K., me NIPT L52122014L, me vlerë të ofertës ekonomike 3.750.000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori Ekonomik “DIXHI PRINT AL” SH.P.K., me NIPT K72210003J, me vlerë të ofertës ekonomike 4.823.900 (katër milion e tetëqind e njëzetë e tre mijë e nëntëqind) lekë pa T.V.SH.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori Ekonomik “KRISTALINA” SH.P.K., me NIPT K11501002D, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

6. Operatori Ekonomik “ FILARA” SH.P.K., me NIPT K51611059N, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrja janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Dixhi print Al” SH.P.K., me NIPT K72210003J, me vlerë 4.823.900 (katër milion e tetëqind e njëzetë e tre mijë e nëntëqind) lekë pa T.V.SH., janë konstatuar këto mangësi:

Përsa i përket kriterit 2.3.4 pjesë e “Dokumentave Standarde të Tenderit” i cili parashikon se: “Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë dhe provojë se zotëron në pronësi ose me kontratë qiraje e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës të paktën:

- Dy makineri printimi/shtypi industrial.

Njëra prej makinerive duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi 3,2 m gjerësi.

Kjo pikë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes të faturave tatimore të blerjes sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është blerë, deklaratën doganore. Në rastin e marrjes me qira, të paraqitet i gjithë dokumentacioni i mësipërm, i cili duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës.”

Operatori Ekonomik në Formularin e Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar fare disponimin e printerave të kërkuar me parametrat e vendosura në kriter (konkretisht gjerësi printimi 3.2 m), por ka deklaruar disponimin e makinave (automjete), që praktikisht nuk lidhen fare me kriterin teknik të kërkuar në DST. Për rrjedhojë, kriteri teknik për disponimin e printerit me gjerësi minimale printimi 3.2 mm për aq kohë sa nuk është pasqyruar në Formularin e Vetëdeklarimit do të konsiderohet si i papërmbyshur. Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që **oferta e mësipërme nuk kualifikohet.***

2. Operatori Ekonomik “Kristalina” SH.P.K., me NIPT K11501002D, janë evidentuar këto mangësi: Në ditën e paracaktuar nga Autoriteti Kontraktor (konkretisht data 16.01.2026, ora 10:00) ku janë ftuar të gjithë Operatorët Ekonomik për të bërë demonstrimin dhe dorëzimin e mostrave referuar kriterit 2.3.6 i cili parashikon se:

2.3.6 Operatori Ofertues, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat fizike për artikujt **1,5,6,9,17**, sipas shtojca 6 të specifikimeve teknike, pa logo të postës dhe të papërsionalizuar.” Në referim dhe të procesverbalit të mbajtur nga KVO ku është pasqyruar prezenca e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, ka rezultuar se **“Kristalina” SH.P.K.,** nuk është paraqitur fare dhe si e tillë kriteri **2.3.6 pjesë e DST-së** konsiderohet totalisht i papërmbyshur.

Gjithashtu, operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në sistemin elektronik asnjë dokument teknik të kërkuar për vlerësimin e ofertës përveç ekstraktit historik i cili nuk përbën dokument teknik dhe nuk shërben për të provuar përputhshmërinë e ofertës me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që **oferta e mësipërme nuk kualifikohet.***

3 Operatori Ekonomik “Filara” SH.P.K. me NIPT K51611059N janë evidentuar këto mangësi: Në ditën e paracaktuar nga Autoriteti Kontraktor (konkretisht data 16.01.2026, ora 10:00) ku janë ftuar të gjithë Operatorët Ekonomik për të bërë demonstrimin dhe dorëzimin e mostrave referuar kriterit 2.3.6 i cili parashikon se:

2.3.6 Operatori Ofertues, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat fizike për artikujt **1,5,6,9,17**, sipas shtojca 6 të specifikimeve teknike, pa logo të postës dhe të papërsionalizuar.”

Në referim dhe të procesverbalit të mbajtur nga KVO ku është pasqyruar prezenca e Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, ka rezultuar se **“Filara” SH.P.K.** nuk është paraqitur fare dhe si e tillë kriteri **2.3.6 pjesë e DST-së konsiderohet totalisht i papërmbushur.**

Për më tepër, nga dokumentacioni i ngarkuar elektronikisht rezulton që Formulari i Ofertës Ekonomike nuk është plotësuar fare, nuk është ngarkuar Sigurimi i Ofertës si dhe nuk është ngarkuar as Formulari i Vetëdeklarimit duke e bërë të pamundur për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave që të vijoi më tej me vlerësimin e pjesëmarrjes së Operatorit Ekonomik.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që **oferta e mësipërme nuk kualifikohet.***

Duke qënë se janë vlerësuar dy oferta të rregullta me të njëjtën vlerë, në mbështetje të nenit 82 pika 6 e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në datë 28.01.2026 në orën 11:00 u hodh shorti ku u paraqitën dy operatorët ekonomik të kualifikuar,

Nga hedhja e shortit rezultoi se;

Vendi i parë: “OPTIMA COMMUNICATION” SH.P.K., me NIPT K71903025A me vlerë të ofertës ekonomike **3.750.000** (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

Vendi i dytë: “INPRESS” sh.p.k me NIPT L52122014L dhe me vlerë të ofertës ekonomike **3.750.000** (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik **“OPTIMA COMMUNICATION” SH.P.K.,** me NIPT K71903025A, me adresë: **Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë,** se oferta e paraqitur, me një vlerë totale **3.750.000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.,** është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Etjen Xhafaj

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSADMINISTRATOR
Ardit Demiri